

URDHËR
Nr.1, datë 6.1.2012

**PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E KRYERJES SË RIMBURSIMIT TË NJËSIVE
TË QEVERISJES VENDORE TË PAGESËS PËR PAJISJET FISKALE DHE
TAKSIMETRAT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 15 të ligjit nr.10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, Ministri i Financave

URDHËRON:

1. Njësitë e qeverisjes vendore, që sipas ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar dhe vendimit nr.1065 datë 29.12.2010 “Për kriteret dhe procedurat e kryerjes së rimbursimit nga taksa e biznesit të vogël, të pagesës për pajisjet fiskale dhe taksimetra” të Këshillit të Ministrave, kanë bërë rimbursimin e subjekteve të biznesit të vogël, brenda datës 30 prill 2011 dhe nuk kanë përfituar të gjithë fondin për kompensimin e vlerës së taksës së biznesit të vogël nga Këshilli i Ministrave, brenda vitit 2011, paraqesin pranë Ministrisë së Financave (sipas formatit bashkëlidhur këtij urdhri), kërkesën për vlerën që kërkohet për t’u rimbursuar.

2. Kërkesa e njërive të qeverisjes vendore duhet të përmbajë:

a) kërkesën me shkrim të firmosur nga nëpunësi i autorizuar, i njësisë, me vlerën e fondit që kërkohet për t’u rimbursuar deri në atë periudhë.

b) listën e subjekteve të biznesit të vogël që kanë përfituar rimbursim për pajisjen fiskale dhe taksimetra (vlerën e saj, përfshirë edhe TVSH-në, por jo më shumë se vlera e përcaktuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.1065, datë 29.12.2010) për ato subjekte që nuk janë të përfshira në skemën e TVSH-së dhe që nuk regjistrohen në këtë skemë brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit nr.10 354, datë 18.11.2010, të rakorduar me degën rajonale të tatim-taksave.

3. Rakordimi i njërive të qeverisjes vendore me degët rajonale të tatim-taksave të bëhet në përputhje me kërkesat e pikës 4 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1065 datë 29.12.2010 “Për kriteret dhe procedurat e kryerjes së rimbursimit nga taksa e biznesit të vogël të pagesës për pajisjet fiskale dhe taksimetra”.

4. Kërkesat për rimbursim dërgohen në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit, pranë Ministrisë së Financave, e cila i administron këto kërkesa deri në përfundimin e procedurës për rimbursimin e njërive vendore, që kanë bërë kërkesë.

5. Me marrjen në dorëzim të këtij dokumentacioni, Ministria e Financave propozon projektvendimin pranë Këshillit të Ministrave, për rimbursimin e vlerës së taksës së biznesit të vogël për njësitë e qeverisjes vendore, sipas vlerave përkatëse, nga zëri kontigjencë, parashikuar në buxhetin e vitit 2012. Ky fond, te njësitë e qeverisjes vendore do të kompensojë pjesën e taksës së biznesit të vogël, e cila ka rimbursuar pajisjen fiskale apo taksimetra.

6. Pas miratimit nga Këshilli i Ministrave, të vendimit për kompensim të njërive të qeverisjes vendore, Ministria e Financave (Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit), bëjnë alokimin e fondeve për rimbursim sipas njërive të qeverisjes vendore, te degët përkatëse të thesarit.

7. Transferimi i fondeve do të kryhet te llogaria buxhetore: entiteti i qeverisjes 001, ministria 10, njësia shpenzuese 1010001, kapitulli 01, programi 01130 (ekzekutimi i pagesave të ndryshme), artikulli 603.3 me emërtimin “Rimbursim për subjektet e biznesit të vogël për vlerën e pajisjeve fiskale”, kodi i degës së thesarit 3535.

Me hyrjen në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave për akordimin e fondeve për kompensimin e vlerës së taksës së biznesit të vogël, që ka shkuar për rimbursimin e vlerës së pajisjeve fiskale, Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit kryen çeljen sipas pikës 7. Drejtoria e

Përgjithshme e Thesarit realizon në sistem kalimin e veprimit në qendër, sipas procedurës së transaksioneve me xhirim të brendshëm (pa lëvizje *cash*), në kategorinë “Xhirime brenda institucionit”, vlerën përkatëse të çdo njësie të qeverisjes vendore në artikullin 7002100 (taksa e biznesit të vogël).

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I FINACAVE

Ridvan Bode